



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhtor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za žalbe i Predstavke

Anr. 364/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ymer Hoxha kryesues, Zyhdi Haziri dhe Rafet Haxhaj anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Bajram Rexhahmetaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidates për deputete të Kuvendit të Republikës së Kosovës Mexhide Mjaku-Topalli nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultatit përfundimtar të publikuar nga KQZ-ja, me datë 29.06.2017, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 02.07.2017, mori këtë:

V E N D I M

- I. Pranohet** si e bazuar ankesa e Kandidates për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Mexhide Mjaku-Topalli nga koalicioni PDK-AAK-NISMA.
- II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidaten për deputete nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, në Vendvotimin 2521D/01D.
- III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të kutisë së votimit në Vendvotimin si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatit përfundimtar.
- IV. Fetije Sadria** me nr. të letërnjoftimit [REDACTED], në cilësinë e Kryesueses të Vendvotimit 2521D/01D, i ndalohet pjesëmarrja në zgjedhje në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite si kandidat dhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, të menaxhuara nën autoritetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).

A R S Y E T I M

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 30.06.2017, nga kandidatja për deputet në Kuvendit e Republikës së Kosovës Mexhide Mjaku-Topalli nga radhët e koalicionit PDK-AAK-NISMA, me të cilën pretendon se në vendvotimin 2521D/01D shkolla “Ganimete Tërbeshi”vendvotimi në qytetin ku ka kandidatura është bërë parregullsi ashtu që votat e sajë gjithsej 79 i janë bartur tek kandidati me nr.67, Nezir Qoqaj. I njëjti gabim është përsëritur edhe tek kandidati me nr. 55, ku 137 vota gabimisht i janë bartur kandidatit me nr. 54, Parashtruesi i ankesës në cilësinë e provës ka bashkangjitur kopjet e FRK-vë me numër 2521d/01d, për vendvotimet në të cilat pretendon se ka pasur parregullsi.

Bazuar në nenin 117. 2 të LZP-së PZAP-i “Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme “

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe materialin zgjedhor e pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

ankesa është e bazuar

PZAP-i ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore dhe gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lendes, si dhe nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve (QNR) për Kutin e Votimit 2521D/01D, është konstatuar se nga origjinali i Formularit të Rezultateve për Kandidat (FRK) kandidatja me nr.69, nga radhët e Koalicionit PDK-AAK-NISMA, Komuna e Ferizaj, ka pasur 1 votë, në FRK-në, e cila është plotësuar në Vendvotim në ditën e votimit, ndërsa pas hetimit të bërë nga paneli, vërtetohet se parashtruesi i ankesës i posedon 79 vota të vlefshme.

Andaj PZAP-i, nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LPZ-së, urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur si në pikën II të dispozitivit.

Me rastin e vendosjes si në pikën -IV-, të dispozitivit të këtij vendimi, përkitazi me masën e shqiptuar për ndalim të kryesuesit të vendvotimit, për pjesëmarrja në zgjedhje në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, si kandidat dhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, të menaxhuara nën autoritetin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), është marrë në bazë të nenit 120 par.3, pika d), të LZP-së, sepse Kryesuesi i çdo Vendvotimi është përgjegjës për sigurinë e integritetit, dhe të qetësisë në procesin e votimit dhe numërimit në vendvotim gjatë ditës së votimit, sipas dispozitës ligjore të nenit 74 par.10 të LZP-së, Në rastin konkret paneli ka vërtetuar se kryesuesi i vendvotimit në fjalë, ka bërë shkelje të dispozitës së sipërcituar sepse parashtruesit të ankesës nuk i janë regjistruar asnjë votë në FRK, ndonëse pasi hetimeve të bëra nga paneli është vërtetuar se i njëjti i posedon 79 vota.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par.3 pika d), të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 364/2017 më datën 02.07.2017.



Këshillë Juridike:

Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.